



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA VLORE
KRYETARI

Nr. 5706 Prot

Vlorë, më 24.03 2026

PROJEKTVENDIM

Nr. _____, datë _____ 2026

“PËR KONSTATIMIN E PAVLEFSHMËRISË ABSOLUTE TË VENDIMEVE NR.25, DATË 28.03.2022 DHE NR.57, DATË 29.07.2022 TË KËSHILLIT TË BASHKISË VLORE”

Në mbështetje të nenit 113 pika 1, shkronja “b” të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; Neneve 149, 163 e vijues të Ligjit nr.7850, datë 29.7.1994, “Kodit Civil i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar; Nenit 8, pika 2, nenit 9, pika 1, nënpika 1.2, shkronja “c”, nenit 54 të Ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar; Neneve 4, 5, 13, 14, 15, 16, 21, 107, 108, 109, 110, 111, 116, 117 të Ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë; ligjit nr.8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar; Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 639, datë 29.09.2007, “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore në Bashkinë Vlorë të Qarkut Vlorë”; Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.1643, datë 17.12.2008, “Për miratimin e listës paraprake të pronave të paluajtshme publike shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të Bashkisë Vlorë të Qarkut të Vlorës”; Vendimit nr.16, datë 08.05.2008, të Këshillit të Bashkisë Vlorë “Për miratimin e listës paraprake të pronave të paluajtshme publike shtetërore, që transferohen në pronësi ose përdorim të Bashkisë Vlorë”; Vendimit nr.25, datë 28.03.2022, të Këshillit të Bashkisë Vlorë “Për një ndryshim në vendimin nr.16, datë 08.05.2008, “Për miratimin e listës paraprake të pronave të paluajtshme publike shtetërore, që transferohen në pronësi ose përdorim të Bashkisë Vlorë”; Vendimit nr.57, datë 29.07.2022, të Këshillit të Bashkisë Vlorë “Për një ndryshim në vendimin nr.16, datë 08.05.2008, “Për miratimin e listës paraprake të pronave të paluajtshme publike shtetërore, që transferohen në pronësi ose përdorim të Bashkisë Vlorë”; me propozimin e Kryetarit të Bashkisë, Këshilli i Bashkisë, në mbledhjen e tij të datës _____ . 2026,

VENDOSI:

1. Konstatimin e pavlefshmërisë absolute të Vendimit nr.25, datë 28.03.2022, të Këshillit të Bashkisë Vlorë “Për një ndryshim në vendimin nr.16, datë 08.05.2008, “Për miratimin e listës

- paraprake të pronave të paluajtshme publike shtetërore, që transferohen në pronësi ose përdorim të Bashkisë Vlorë”.
2. Konstatimin e pavlefshmërisë absolute të Vendimit nr.57, datë 29.07.2022, të Këshillit të Bashkisë Vlorë “Për një ndryshim në vendimin nr.16, datë 08.05.2008, “Për miratimin e listës paraprake të pronave të paluajtshme publike shtetërore, që transferohen në pronësi ose përdorim të Bashkisë Vlorë”.
 3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari dhe Administrata e Bashkisë Vlorë.
 4. Ky vendim hyn në fuqi sipas parashikimeve të nenit 55/6 të Ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar.

KRYETAR
Brunilda Mersini





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA VLORË
KRYETARI

Nr. 5706 Prot

Vlorë, më 24.03 2026

RELACION

“PËR KONSTATIMIN E PAVLEFSHMËRISË ABSOLUTE TË VENDIMEVE NR.25, DATË 28.03.2022 DHE NR.57, DATË 29.07.2022 TË KËSHILLIT TË BASHKISË VLORË”

Në mbështetje të nenit 113 pika 1, shkronja “b” të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; Neneve 149, 163 e vijues të Ligjit nr.7850, datë 29.7.1994, “Kodit Civil i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar; Nenit 8, pika 2, nenit 9, pika 1, nënpika 1.2, shkronja “c”, nenit 54 të Ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar; Neneve 4, 5, 13, 14, 15, 16, 21, 107, 108, 109, 110, 111, 116, 117 të Ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë; Ligjit nr.8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar; Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 639, datë 29.09.2007, “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore në Bashkinë Vlorë të Qarkut Vlorë”; Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.1643, datë 17.12.2008, “Për miratimin e listës paraprake të pronave të paluajtshme publike shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të Bashkisë Vlorë të Qarkut të Vlorës”; Vendimit nr.16, datë 08.05.2008, të Këshillit të Bashkisë Vlorë “Për miratimin e listës paraprake të pronave të paluajtshme publike shtetërore, që transferohen në pronësi ose përdorim të Bashkisë Vlorë”; Vendimit nr.25, datë 28.03.2022, të Këshillit të Bashkisë Vlorë “Për një ndryshim në vendimin nr.16, datë 08.05.2008, “Për miratimin e listës paraprake të pronave të paluajtshme publike shtetërore, që transferohen në pronësi ose përdorim të Bashkisë Vlorë”; Vendimit nr.57, datë 29.07.2022, të Këshillit të Bashkisë Vlorë “Për një ndryshim në vendimin nr.16, datë 08.05.2008, “Për miratimin e listës paraprake të pronave të paluajtshme publike shtetërore, që transferohen në pronësi ose përdorim të Bashkisë Vlorë”, po ju parashtrojmë relacionin si më poshtë vijon:

Ky projektvendim paraqitet për shqyrtim dhe miratim nga Këshilli i Bashkisë Vlorë në mbështetje të kuadrit ligjor në fuqi për organizimin dhe funksionimin e njërive të vetëqeverisjes vendore, si dhe për administrimin e pronës publike.

Qëllimi i këtij projektvendimi është rivendosja e ligjshmërisë në veprimtarinë vendimmarrëse të Këshillit të Bashkisë Vlorë, përmes konstatimit absolutisht të pavlefshëm të dy vendimeve të mëparshme të këtij këshilli, të cilat kanë disponuar në dy kohë të ndryshme për heqjen nga lista paraprake e pronave të paluajtshme publike shtetërore të transferuara në pronësi ose përdorim të Bashkisë Vlorë, të pjesëve të një pasurie të paluajtshme me arsyetimin se është pronë private.

Nga analiza juridike e bazës ligjore dhe e dokumentacionit përkatës rezulton se Vendimi nr.25, datë 28.03.2022, i Këshillit të Bashkisë Vlorë “Për një ndryshim në vendimin nr.16, datë 08.05.2008, “Për miratimin e listës paraprake të pronave të paluajtshme publike shtetërore, që transferohen në pronësi ose përdorim të Bashkisë Vlorë” dhe Vendimi nr.57, datë 29.07.2022, i Këshillit të Bashkisë Vlorë “Për një ndryshim në vendimin nr.16, datë 08.05.2008, “Për miratimin e listës paraprake të pronave të paluajtshme publike shtetërore, që transferohen në pronësi ose përdorim të Bashkisë Vlorë”, janë marrë në mungesë kompetence materiale dhe në tejkalim të tagrave të pronësisë/administrimit të pronës nga ana e Këshillit të Bashkisë.

Bazuar në Ligjin nr.8744, datë 22.2.2001, “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr.639, datë 29.9.2007, është miratuar lista e inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore që ndodhen brenda juridiksionit territorial dhe administrativ të Bashkisë Vlorë, listë e cila përfundonte me numrin rendor 825, ku në numrin rendor 831 ishte numërtuar pasuria me sipërfaqe 1500m/2, zona kadastrale 8604, e emërtuar “Tregu i Çoles”. Në pikën 2 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.639, datë 29.9.2007, është përcaktuar: “2. *Ndryshimet, që mund t’i bëhen listës gjatë periudhës së afishimit, të pasqyrohen në listën përfundimtare të pronave, e cila miratohet nga Këshilli i Ministrave.*”.

Pas miratimit të listës së inventarit me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr.639, datë 29.9.2007, Këshilli i Bashkisë Vlorë me Vendimin nr.16, datë 08.05.2008, ka miratuar listën paraprake të pronave të paluajtshme publike shtetërore, që transferohen në pronësi ose përdorim të Bashkisë Vlorë, ku në numrin rendor 831 ishte numërtuar pasuria me sipërfaqe 1500m/2, zona kadastrale 8604, e emërtuar “Tregu i Çoles”.

Në vijim të procedurës së parashikuar nga Ligji nr.8744, datë 22.2.2001, “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr.1643, datë 17.12.2008, është miratuar lista paraprake e pronave publike shtetërore që transferohen në pronësi ose në përdorim të Bashkisë Vlorë ku në pikën nr.1 përcaktohet: “1. *Miratimin e listës paraprake të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen, në pronësi ose në përdorim të bashkisë Vlorë, të qarkut të Vlorës sipas lidhjes nr.1, që i bashkëlidhet këtij vendimi. Lista paraprake, sipas kërkesave të këshillit të kësaj bashkie, është pjesë e listës së inventarit të pronave të paluajtshme publike shtetërore, që janë brenda juridiksionit territorial dhe administrativ të bashkisë Vlorë të qarkut të Vlorës, miratuar me vendimin nr.639, datë 29.9.2007, të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore në Bashkinë Vlorë, të qarkut të Vlorës*”.

Nga lidhja nr.1 bashkëlidhur këtij vendimi rezulton se pasuria e pasqyruar në numrin rendor 831, pra pasuria me sipërfaqe 1500m/2, e ndodhur në zonën kadastrale 8604, e emërtuar “Tregu i Çoles”, nuk ka kaluar as në pronësi dhe as në përdorim të Bashkisë Vlorë.

Aktet e mësipërme përbëjnë bazën juridike për përcaktimin e pasurive që kalojnë në pronësi ose administrim të njësisë së qeverisjes vendore dhe kanë karakter detyrues për organet vendore.

Rezulton gjithashtu se pjesë e pasurisë me sipërfaqe 1500m/2, e ndodhur në zonën kadastrale 8604, e emërtuar “Tregu i Çoles”, janë pasuria nr.19/198 me sipërfaqe 700m/2 e cila figuron në bashkëpronësi të shtetasve Ëngjëll Hamitaj, Bardhyl Hamitaj, Agim Veraj si edhe pasuria nr.19/199/3 me sipërfaqe 400m/2 e cila figuron në pronësi të shtetasit Festim Meçani.

Me vendimin nr.25, datë 28.03.2022, bazuar në kërkesën e shtetasit Ëngjëll Hamitaj, Këshilli i Bashkisë Vlorë ka vendosur ndryshimin e vendimit nr.16, datë 08.05.2008, “Për miratimin e listës paraprake të pronave të paluajtshme publike shtetërore, që transferohen në pronësi ose përdorim të Bashkisë Vlorë”, duke përcaktuar se nga sipërfaqja e pasurisë së pasqyruar në numrin rendor 831, e ndodhur në zonën kadastrale 8604, e emërtuar “Tregu i Çoles”, pakësohet sipërfaqja 234m/2 sipas skicës bashkëlidhur duke ju kthyer shtetasit Ëngjëll Hamitaj një prej pronarëve të sipërfaqes së truallit 700m/2, pra duke bërë në fakt pjestimin e pasurisë private.

Me vendimin nr.57, datë 29.07.2022, bazuar në kërkesën e shtetasve Bardhyl Hamitaj, Agim Veraj, Festim Meçani Këshilli i Bashkisë Vlorë ka vendosur ndryshimin e vendimit nr.16, datë 08.05.2008, “Për miratimin e listës paraprake të pronave të paluajtshme publike shtetërore, që transferohen në pronësi ose përdorim të Bashkisë Vlorë”, duke përcaktuar se nga sipërfaqja e pasurisë së pasqyruar në numrin rendor 831, e ndodhur në zonën kadastrale 8604, e emërtuar “Tregu i Çoles”, pakësohet sipërfaqja 466.6m/2 sipas skicës bashkëlidhur duke ju kthyer dy prej bashkëpronarëve të sipërfaqes së truallit 700m/2 ndërsa një sipërfaqe prej 400m/2 i është kthyer pronarit Festim Meçani.

Pra, pavarësisht se nga lista paraprake e miratuar me VKM nr.1643, datë 17.12.2008, rezulton se pasuria objekt i vendimeve nr.25, datë 28.03.2022 dhe nr.57, datë 29.07.2022 të Këshillit të Bashkisë nuk është e përfshirë në këtë listë dhe nuk ka qenë objekt transferimi në pronësi apo në përdorim të Bashkisë Vlorë, Këshilli i Bashkisë ka vendosur heqjen e kësaj pasurie nga lista paraprake duke ua kthyer shtetasit Ëngjëll Hamitaj (Vendimi nr.25, datë 28.03.2022) dhe shtetasve Bardhi Hamitaj, Agim Veraj, Festim Meçani (Vendimi nr.57, datë 29.07.2022).

Në përputhje me legjislacionin në fuqi për administrimin e pronës publike shtetërore, transferimi i pronave nga shteti tek njësitë e vetëqeverisjes vendore realizohet vetëm në bazë të vendimeve të Këshillit të Ministrave. Lista e miratuar me VKM nr.1643, datë 17.12.2008 përcakton në mënyrë të qartë dhe shteruese pasuritë që transferohen në pronësi ose në përdorim të Bashkisë Vlorë.

Përderisa pasuritë objekt i vendimeve nr.25, datë 28.03.2022 dhe nr.57, datë 29.07.2022, të Këshillit të Bashkisë Vlorë nuk janë të përfshira në këtë listë, rezulton se:

- Këto pasuri nuk kanë kaluar në pronësi apo në administrim të Bashkisë Vlorë;
- Bashkia nuk ka fituar asnjë titull juridik mbi to;
- Këshilli i Bashkisë nuk ka pasur tagër ligjor për të disponuar apo për të marrë vendime lidhur me statusin juridik të këtyre pasurive aq më tepër të kryente pjestimin faktik ndërmjet bashkëpronarëve.

Vendimmarrja e Këshillit të Bashkisë për heqjen e këtyre pasurive nga lista paraprake dhe pjestimi në fakt i saj ndërmjet bashkëpronarëve rezulton juridikisht e pabazuar edhe për faktin se një organ administrativ nuk mund të ndryshojë ose të modifikojë përmbajtjen e një akti të nxjerrë nga një organ më i lartë administrativ apo të marrë kompetenca që i takojnë gjykatës.

Në kuptim të parimeve të së drejtës administrative dhe të parashikimeve të Kodit të Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë, një akt administrativ i nxjerrë nga një organ publik në

mungesë kompetence materiale dhe në kundërshtim me dispozitat urdhëruese të Kodit Civil që rregullojnë të drejtat e pronësisë konsiderohet akt absolutisht i pavlefshëm. Në këtë kuptim organi që e ka nxjerrë ka jo vetëm të drejtën por edhe detyrimin ta konstatojë këtë fakt me qëllim rivendosjen e ligjshmërisë në veprimtarinë administrative (neni 117 i Kodit të Procedurave Administrative).

Në këtë kuptim, konstatimi i pavlefshmërisë së këtyre vendimeve të Këshillit të Bashkisë përbën ushtrim të ligjshëm të kompetencës së këtij organi për të rivendosur ligjshmërinë në veprimtarinë e tij vendimmarrëse.

Në rrethanat kur vendimet objekt shqyrtimi janë marrë në mungesë kompetence materiale pasi kanë disponuar për pasuri që nuk kanë kaluar në pronësi apo administrim të Bashkisë dhe që nuk kanë qenë pjesë e listës paraprake të miratuar me VKM nr.1643, datë 17.12.2008 ndërhyrja e Këshillit të Bashkisë për konstatimin e pavlefshmërisë absolute të këtyre vendimeve përbën një masë të domosdoshme për garantimin e respektimit të rendit juridik dhe të kompetencave të përcaktuara nga ligji për organet e vetëqeverisjes vendore dhe përputhjes së veprimtarisë së Këshillit të Bashkisë me kuadrin ligjor në fuqi..

Konstatimi i pavlefshmërisë absolute të këtyre akteve nuk krijon pasoja juridike mbi statusin e pronësisë së pasurive në fjalë por vetëm korrigjim të vendimmarrjeve të mëparshme të kryera në mungesë kompetence nga organi i vetëqeverisjes vendore.

Në përfundim, duke qenë se pasuritë objekt disponimi të Vendimeve nr.25, datë 28.03.2022 dhe nr.57, datë 29.07.2022, të Këshillit të Bashkisë Vlorë nuk kanë qenë pjesë e listës paraprake të miratuar me VKM nr.1643, datë 17.12.2008 dhe nuk kanë kaluar në pronësi apo administrim të Bashkisë Vlorë, si dhe duke konstatuar se vendimet përkatëse janë marrë në tejkalim të tagrave të administrimit të pronës publike, propozohet miratimi i projektvendimit për konstatimin e pavlefshmërisë absolute të tyre.

Bashkëlidhur:

1. Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr. 639, datë 29.09.2007, “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore në Bashkinë Vlorë të Qarkut Vlorë”, botuar ne Fletoren Zyrtare nr.133, datë 11.10.2007, në 4 fletë;
2. Vendimi i Këshillit të Ministrave nr.1643, datë 17.12.2008, “Për miratimin e listës paraprake të pronave të paluajtshme publike shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të Bashkisë Vlorë të Qarkut të Vlorës”, botuar ne Fletoren Zyrtare nr.198, Dhjetor 2008, në 4 fletë;
3. Vendimi nr.16, datë 08.05.2008, i Këshillit të Bashkisë Vlorë “Për miratimin e listës paraprake të pronave të paluajtshme publike shtetërore, që transferohen në pronësi ose përdorim të Bashkisë Vlorë” dhe praktika bashkëlidhur nxjerrë nga Arkiva e Bashkisë Vlorë, në 5 fletë;
4. Vendimi nr.25, datë 28.03.2022, i Këshillit të Bashkisë Vlorë “Për një ndryshim në vendimin nr.16, datë 08.05.2008, “Për miratimin e listës paraprake të pronave të paluajtshme publike shtetërore, që transferohen në pronësi ose përdorim të Bashkisë Vlorë” dhe praktika bashkëlidhur nxjerrë nga Arkiva e Bashkisë Vlorë, në 38 fletë;
5. Vendimi nr.57, datë 29.07.2022, i Këshillit të Bashkisë Vlorë “Për një ndryshim në vendimin nr.16, datë 08.05.2008, “Për miratimin e listës paraprake të pronave të paluajtshme publike shtetërore, që transferohen në pronësi ose përdorim të Bashkisë Vlorë” dhe praktika bashkëlidhur nxjerrë nga Arkiva e Bashkisë Vlorë në 53 fletë;

6. Shkresa nr.273/1, datë 17.02.2026 e Prefektit të Qarkut Vlorë dhe praktika bashkëlidhur ne 6 fletë.

KRYETAR
Brunilda Mersini



31/10/2026
SHK. E SHK.



200-11
19-02 2026

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT VLORË
SEKTORI JURIDIK

Nr. 273/prot.
1

Vlorë, më 17.02. 2026

Lënda: Vendorsje në dispozicion dokumentacioni

BASHKISË VLORË
Vlorë

Në vijim suajës, me nr. 2860 prot., datë 11.02.2026, protokolluar pranë institucionit tonë me nr. 273 prot., datë 12.02.2026, me anë të të cilës kërkoni kopje të njesuar me origjinalin për vendimin me nr. 57 të datës 29.07.2022, Vendimin me nr. 25, datë 28.03.2022 dhe Vendimin me nr. 16, datë 08.05.2008 të Bashkisë Vlorë, bazuar në ligjin nr. 107/2016 "Për Prefektin e Qarkut", i ndryshuar, ligjin nr. 9154, datë 06.11.2023 "Për Arkivat", ju bëjmë me dije se:

Po ju vendosim në dispozicion:

- Shprehjen e ligjshmërisë me nr. 546/1, prot., datë 15.05.2008. 1(një)fletë
- Shprehjen e ligjshmërisë me nr. 288/2 prot., datë 04.04.2022. 2(dy)fletë
- Shprehjen e ligjshmërisë me nr. 704/1 prot., datë 10.08.2022. 2(dy) fletë

Duke ju falenderuar,




PREFEKTI

Evis Allushi



REPUBLIKA E SHQIPERISE
PREFEKTI I QARKUT VLORE
Sektori Juridik dhe Funksiioneve te Deleguara



Nr. 546/.....Prot.

Vlore, me 13.05.08

Lenda : Shprehja per ligjshmerine e vendimit te Keshillit te Bashkise Vlore

Drejtuar : Z. Shpetim GJIKA
Kryetar i Bashkise
Vlore

Per dijeni : Keshillit te Bashkise
Vlore

Ne mbeshtetje dhe zbatim te neneve 6 dhe 14 te Ligjit Nr.8927, date 25.07.2002 "Per Prefektin", shprehemi si me poshte :

1. Vendimi i Keshillit te Bashkise Nr.15, date 08.05.2008 " Mbi proceset gjyqesore te Bashkise Vlore", **miratohet si kopetence.**

2. Vendimi i Keshillit te Bashkise Nr. 16 date 08.05.2008 " Mbi miratimin e listes paraprake te pronave te paluajteshme publike shteterore qe transferohen ne pronesi ose ne perdorim te Bashkise Vlore", **miratohet si procedure.**

3. Vendimi i Keshillit te Bashkise Nr. 18 date 08.05.2008, " Mbi vendosjen e gjobave per shkeljet e kryera nga shoqerite e ndertimit" , **miratohet si kopetence.**

4. Vendimi i Keshillit te Bashkise Nr. 19 date 08.05.2008 , " Mbi menyren dhe masen e perdorimit te te ardhurave financiare te krijuara nga biletat dhe qerate ne institucionet e Qendres Kulturore Vlore" , **vleresohet i ligjshem.**

5. Vendimi i Keshillit te Bashkise Nr. 20 date 08.05.2008, "Per shperblim per titullin, kampion ne basketboll femra dhe kupa e Shqiperise per te rritur ne peshengritje" **vleresohet i ligjshem.**

6. Vendimi i Keshillit te Bashkise Nr. 21 date 08.05.2008, "Mbi miratimin e ngritjes se komisiioneve per dhenien e Licensave Profesionale per Sherbimet Publike dhe funksionimin e tyre" **vleresohet i ligjshem.**

Shprehja e ligjshmerise si me siper i njoftohet per zbatim Kryetarit te Bashkise. U konfirmua sot me 13.05.2008.

PREFEKTI

Xhevaif REXHEPI





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT VLORE
SEKTORI JURIDIK



Nr. 288/prot.
2

Vlorë, më 04.04.2022

Lënda: Shprehje për ligjshmërinë e vendimit të Këshillit të Bashkisë Vlorë

KRYETARIT TË BASHKISË VLORE

Për dijeni: KËSHILLIT TË BASHKISË VLORE

Në vijim suajës me nr. 3000/1 prot., datë 29.03.2022, protokolluar me Tonën me nr.288, datë 29.03.2022, si dhe në mbështetje dhe zbatim të neneve 8 dhe 16 të ligjit nr.107/2016 "Për Prefektin e Qarkut", shprehemi si më poshtë vijon:

1. Vendimi i Këshillit të Bashkisë Vlorë nr.18, datë 28.03.2022, "Për dhënien e ndihmës ekonomike nga të ardhurat e Bashkisë për muajin shkurt 2022", **vlerësohet i ligjshëm.**
2. Vendimi i Këshillit të Bashkisë Vlorë nr.19, datë 28.03.2022, "Për dhënien e ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar për muajin shkurt 2022", **vlerësohet i ligjshëm.**
3. Vendimi i Këshillit të Bashkisë Vlorë nr.20, datë 28.03.2022, "Për miratimin e vlerës financiare të dëmeve të shkaktuara nga djegia në banesën e z.Jonus Lalaj në datën 29.12.2021 dhe shpërblimin financiar nga ana e Bashkisë Vlorë", **bazuar në ligjin nr. 44/2015 "Kodi i Procedurave Administrative", neni 3/1(a), akti ka karakter individual.**
4. Vendimi i Këshillit të Bashkisë Vlorë nr.21, datë 28.03.2022, "Për miratimin e vlerës financiare të dëmeve të shkaktuara nga djegia në banesën e z.Ilirjan Skëndaj në datën 03.01.2022 dhe shpërblimin financiar nga ana e Bashkisë Vlorë", **bazuar në ligjin nr. 44/2015 "Kodi i Procedurave Administrative", neni 3/1(a), akti ka karakter individual.**
5. Vendimi i Këshillit të Bashkisë Vlorë nr.22, datë 28.03.2022, "Për miratimin e vlerës financiare të dëmeve të shkaktuara nga djegia në banesën e zj.Adriola Ruko në datën 01.01.2022 dhe shpërblimin financiar nga ana e Bashkisë Vlorë", **bazuar në ligjin nr. 44/2015 "Kodi i Procedurave Administrative", neni 3/1(a), akti ka karakter individual.**

6. Vendimi i Këshillit të Bashkisë Vlorë nr.78, datë 02.12.2021 "Për miratimin e numrit të punonjësve të bashkisë, institucioneve të varësisë dhe funksioneve të deleguara-2022", **vlerësohet i ligjshëm.**
7. Vendimi i Këshillit të Bashkisë Vlorë nr.24, datë 28.03.2022, "Përnjë shtesë në VKB nr. 84 datë 16.12.2021 lënë në fuqi me VKB nr. 4 datë 31.01.2022 "Për buxhetin e Bashkisë Vlorë për vitin 2022", **vlerësohet i ligjshëm.**
8. Vendimi i Këshillit të Bashkisë Vlorë nr.25, datë 28.03.2022, "Për një ndryshim në vendimin nr.16 datë 08.05.2008 të këshillit të bashkisë "Miratimi i listës paraprake të pronave të paluajtshme publike shtetërore që transferohen në pronësi ose në përdorim të Bashkisë Vlorë", **vlerësohet i ligjshëm.**
9. Vendimi i Këshillit të Bashkisë Vlorë nr.26, datë 28.03.2022, "Për miratimin e rregullores së administrimit të bashkëpronësisë në ndërtesat e banimit në Bashkinë Vlorë", **vlerësohet i ligjshëm.**
10. Vendimi i Këshillit të Bashkisë Vlorë nr.27, datë 28.03.2022, "Për miratimin e listës së familjeve dhe individëve që përfitojnë subvencionin e qirasë në treg të lirë dhe vlerat e subvencionit të qirasë për çdo rast ", **vlerësohet i ligjshëm.**

Duke ju falenderuar,



PREFEKTI

Flamur Mamaj
Flamur Mamaj

Grupi i punës: O. Zaimi

S. Hysaj

I. Dalipaj

Z. Bilalaj

L. Sinanaj

R. Skëndaj

Datë : 04.04.2022

Adresa: L."H. Çakërrri" Rr."S.Delvina" Vlorë, Tel/Fax 33 424105 E-mail prefektiqarkutvlore@gmail.com



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT VLORË
SEKTORI JURIDIK



Nr. 704/1 prot.

Vlorë, më 10.08.2022

Lënda: Shprehje për ligjshmërinë e vendimit të Këshillit të Bashkisë Vlorë

KRYETARIT TË BASHKISË VLORË

Për dijëni: KËSHILLIT TË BASHKISË VLORË

Në vijim suajës me nr.8369/1 prot., datë 05.08.2022, protokolluar me Tonën me nr.704, datë 05.08.2022, si dhe në mbështetje dhe zbatim të neneve 8 dhe 16 të ligjit nr.107/2016 "Për Prefektin e Qarkut", shprehëmi si më poshtë vijon:

1. Vendimi i Këshillit të Bashkisë Vlorë nr.52, datë 29.07.2022, "Për dhënien e ndihmës ekonomike nga të ardhurat e Bashkisë për muajin qershor 2022", **vlerësohet i ligjshëm.**
2. Vendimi i Këshillit të Bashkisë Vlorë nr.53, datë 29.07.2022, "Për dhënien e ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar për muajin qershor 2022", **vlerësohet i ligjshëm.**
3. Vendimi i Këshillit të Bashkisë Vlorë nr.54, datë 29.07.2022, "Për miratimin e vlerës financiare të dëmeve të shkaktuara nga djegja e banesës së z.Sokol Pali në datë 09.05.2022, dhe shpërblimin financiar nga ana e Bashkisë Vlorë", **bazuar në ligjin nr. 44/2015 "Kodi i Procedurave Administrative", neni 3/1(a), akti ka karakter individual.**
4. Vendimi i Këshillit të Bashkisë Vlorë nr.55, datë 29.07.2022, "Për miratimin e vlerës financiare të dëmeve të shkaktuara nga djegja e banesës së z.Eljon Brahimaj në datë 08.02.2022, dhe shpërblimin financiar nga ana e Bashkisë Vlorë", **bazuar në ligjin nr. 44/2015 "Kodi i Procedurave Administrative", neni 3/1(a), akti ka karakter individual.**
5. Vendimi i Këshillit të Bashkisë Vlorë nr.56, datë 29.07.2022, "Për miratimin e programit buxhetor afatmesëm përfundimtar 2023-2025", **vlerësohet i ligjshëm.**
6. Vendimi i Këshillit të Bashkisë Vlorë nr.57, datë 29.07.2022, "Për një ndryshim në vendimin nr.16 datë 08.05.2008 të Këshillit të Bashkisë "Miratimi i listës paraprake të pronave të paluajtshme publike shtetërore që transferohen në pronësi ose përdorim të Bashkisë Vlorë", **bazuar në ligjin nr. 44/2015 "Kodi i Procedurave Administrative", neni 3/1(a), akti ka karakter individual.**



7. Vendimi i Këshillit të Bashkisë Vlorë nr.58, datë 29.07.2022, “Për miratimin e projekt propozimit termo-Hidroizolim i soletës së shkollës 9-vjeçare “15 Tetori” mbështetur nga shoqata për autonomi Vendore në Shqipëri ”, **vlerësohet i ligjshëm.**
8. Vendimi i Këshillit të Bashkisë Vlorë nr.59, datë 29.07.2022, “Për miratimin e listës së familjeve dhe individëve, që përfitojnë banesë me kosto të ulët, nëpërmjet subvencionimit të interesave të kredive nga buxheti i shtetit”, **vlerësohet i ligjshëm.**
9. Vendimi i Këshillit të Bashkisë Vlorë nr.60, datë 29.07.2022, “Për miratimin e orarit në të cilin lejohet gjenerimi i zhurmave gjatë sezonit turistik”, **vlerësohet i ligjshëm.**

Duke ju falenderuar,

P R E F E K T I


Flamur Mamaj


Grupi i punës: O. Zaimi

S. Hysaj

Z. Jaupaj

R. Skëndaj

Datë : 08.08.2022



FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

www.legjislacionishqiptar.gov.al

Nr.133

11 tetor

2007

P Ë R M B A J T J A

	Faqe
Vendim i KM nr.629, datë 12.9.2007	Për ndryshimin e përgjegjësisë së administrimit të katit përdhe, bodrumit, të mjediseve të tjera dhe të territorit të ish-spitalit civil të Shkodrës nga Ministria e Shëndetësisë Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës, për Universitetin e Shkodrës 3675
Vendim i KM nr.630, datë 29.9.2007	Për një ndryshim në vendimin nr.135, datë 14.3.2007 të Këshillit të Ministrave "Për krijimin e Agjencisë Qendrore të Vlerësimit të Arritjeve të Nxënësve dhe për shkrirjen e Qendrës Kombëtare Arsimore të Vlerësimit dhe të Provimeve" 3680
Vendim i KM nr.631, datë 29.9.2007	Për miratimin e listës paraprake të pronave të paluajtshme publike shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim, të komunës Mollas të qarkut të Elbasanit..... 3680
Vendim i KM nr.632, datë 29.9.2007	Për përcaktimin e rasteve të përjashtimit të pagesave cash për blerje mallrash dhe shërbimesh..... 3681
Vendim i KM nr.634, datë 29.9.2007	Për shpronësimin, për interes publik, të pronarit të pasurisë së paluajtshme, pronë private, që preket nga zgjerimi i varrezave të Tufinës, Tiranë 3682
Vendim i KM nr.635, datë 29.9.2007	Për ndryshimin e përgjegjësisë së administrimit të ndërtesës së ndërmarrjes gjeologjike, Korçë, nga Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës te Ministria e Financave..... 3685
Vendim i KM nr.636, datë 29.9.2007	Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, në komunën Zagorie të qarkut të Gjirokastrës 3690

Vendim i KM nr.637, datë 29.9.2007	Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, në bashkinë Roskovec të qarkut të Fierit.....	3690
Vendim i KM nr.638, datë 29.9.2007	Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, në komunën Sinjë të qarkut të Beratit	3691
Vendim i KM nr.639, datë 29.9.2007	Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, në bashkinë Vlorë të qarkut të Vlorës	3691

VENDIM
Nr.638, datë 29.9.2007

**PËR MIRATIMIN E LISTËS SË INVENTARIT TË PRONAVE TË PALUAJTSHME
SHTETËRORE, NË KOMUNËN SINJË TË QARKUT TË BERATIT**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 3 të nenit 8 të ligjit nr.8743, datë 22.2.2001 "Për pronat e paluajtshme të shtetit", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, që janë në juridiksionin, territorial dhe administrativ, të komunës Sinjë të qarkut të Beratit, sipas propozimit të paraqitur nga këshilli i kësaj komune.

Lista me 127 (njëqind e njëzet e shtatë) fletë, që i bashkëlidhet këtij vendimi, përfundon me numrin rendor 869 (tetëqind e gjashtëdhjetë e nëntë).

2. Ndryshimet, që mund t'i bëhen listës gjatë periudhës së afishimit, të pasqyrohen në listën përfundimtare të pronave, e cila miratohet nga Këshilli i Ministrave.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
SALI BERISHA

VENDIM
Nr.639, datë 29.9.2007

**PËR MIRATIMIN E LISTËS SË INVENTARIT TË PRONAVE TË PALUAJTSHME
SHTETËRORE, NË BASHKINË VLORË TË QARKUT TË VLORËS**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 3 të nenit 8 të ligjit nr.8743, datë 22.2.2001 "Për pronat e paluajtshme të shtetit", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, që janë në juridiksionin, territorial dhe administrativ, të bashkisë Vlorë të qarkut të Vlorës, sipas propozimit të paraqitur nga këshilli i kësaj bashkie.

Lista me 81 (tetëdhjetë e një) fletë, që i bashkëlidhet këtij vendimi, përfundon me numrin rendor 825 (tetëqind e njëzet e pesë).

2. Ndryshimet, që mund t'i bëhen listës gjatë periudhës së afishimit, të pasqyrohen në listën përfundimtare të pronave, e cila miratohet nga Këshilli i Ministrave.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi "Zhan d'Ark", prapa ish-ekspozitës "Shqipëria Sot", nr.tel: 04 258 472 (Kryeredaktori)
Çmimi i abonimit në postë për Fletoret Zyrtare 2007 është 16 000 lekë.

BOTIMET E QENDRËS SË PUBLIKIMEVE ZYRTARE

1. KUSHTETUTA E SHQIPËRISË
2. KODET E LEGJISLACIONIT SHQIPTAR
3. REGJISTRAT E NOTERISË
4. PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI NË FUSHA TË NDRYSHME

BOTIME TË REJA (Të përditësuara gusht 2007)

KODI PENAL

KODI I PROCEDURËS PENALE

KODI CIVIL

KODI I PROCEDURËS CIVILE

KODI I PROCEDURËS ADMINISTRATIVE

Së shpejti në treg:

- Përmbledhëse e legjislacionit për taksa dhe tatime
- Përmbledhëse e legjislacionit për pronat
- Kodi i familjes (përfshirë legjislacioni për birësimet)

Hyri në shtyp më 9.10.2007

Doli nga shtypi më 11.10.2007

Tirazhi: 3500 ccpë

Formati: 61x86/8

Shtypshkronja "Nënë Tereza"
Tiranë, 2007

Çmimi 20 lekë



FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

www.legjislacionishqiptar.gov.al

www.qpz.gov.al

Nr.198

dhjetor

2008

P Ë R M B A J T J A

		Faqe
Dekret nr.5987 datë 29.12.2008	Për lejim lënie të shtetësisë shqiptare	10785
Dekret nr.5989 datë 30.12.2008	Për lejim lënie të shtetësisë shqiptare	10786
Vendim i KM nr.1631, datë 17.12.2008	Për shpalljen "Park kombëtar" të ekosistemit natyror Bredhi i Hotovës-Dangëlli me sipërfaqe të zgjeruar	10786
Vendim i KM nr.1633, datë 17.12.2008	Për disa ndryshime në vendimin nr.279, datë 5.6.1995 të Këshillit të Ministrave "Për përcaktimin e sasisë së ujit për furnizimin me ujë të qytetit të Tiranës dhe për ujitjen e tokave bujqësore"	10790
Vendim i KM nr.1634, datë 17.12.2008	Për përcaktimin e procedurave dhe të mënyrës së mbështetjes financiare, për ruajtjen e rezervës gjenetike të racës autoktone të buajve	10790
Vendim i KM nr.1635, datë 17.12.2008	Për miratimin, në parim, të marrëveshjes, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Shtetit të Kuvajtit, për shmangien e tatimit të dyfishtë dhe parandalimin e evazionit fiskal, për tatimet mbi të ardhurat dhe kapitalin	10791
Vendim i KM nr.1636, datë 17.12.2008	Për hapjen e programeve të studimit, të ciklit të dytë, në universitetin "Ismail Qemali", Vlorë, si dhe për miratimin e kuotave të pranimit të tarifës së shkollimit në këto programe në vitin akademik 2008-2009	10792

Vendim i KM nr.1637, datë 17.12.2008	Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajjtshme shtetërore, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi Agjencisë Kombëtare të Burimeve Natyrore	10783
Vendim i KM nr.1638, datë 17.12.2008	Për kriteret e vlerësimit të pronës shtetërore, që privatizohet apo transformohet, dhe për procedurën e shitjes	10795
Vendim i KM nr.1641, datë 17.12.2008	Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajjtshme publike, shtetërore, që transferohen, në pronësi ose në përdorim, të komunës Voskop, të qarkut të Korçës	10802
Vendim i KM nr.1642, datë 17.12.2008	Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajjtshme publike, shtetërore, që transferohen, në pronësi ose në përdorim, të bashkisë Përrenjas, të qarkut të Elbasanit	10803
Vendim i KM nr.1643, datë 17.12.2008	Për miratimin e listës paraprake të pronave të paluajjtshme publike, shtetërore, që transferohen, në pronësi ose në përdorim, të bashkisë Vlorë, të qarkut të Vlorës	10805
Vendim i ERE nr.107, datë 9.9.2008	Për disa ndryshime në deklaratën rregullatore të miratuar me vendimin nr.94, datë 14.8.2008 “Për disa ndryshime në vendimin nr.87, datë 6.8.2008 “Për miratimin e deklaratës rregullatore në kuadër të zbatimit të metodologjive të llogaritjes së tarifave të energjisë elektrike””	10806
Vendim i ERE nr.132, datë 9.12.2008	Për kualifikimin e impiantit prodhues (parku eolik Kryevidh, Kavajë) të shoqërisë “Union Eolica Albania” sh.p.k., si burim i rinovueshëm energjie	10811
Vendim i ERE nr.133, datë 9.12.2008	Për revokimin e vendimit nr.46, datë 10.8.2007 “Për përcaktimin e vlerës së gjobave dhe llogaritjes së dëmit që do të aplikohen ndaj klientëve me kundërvajtje në përdorimin e energjisë elektrike”, të ndryshuar	10811
Vendim i ERE nr.134, datë 11.12.2008	Për miratimin e rregullave dhe procedurave të shitjes së energjisë elektrike te furnizuesit vendas e të huaj	10812

	produktive).	
516-522,536,539,557-564	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (kanale të treta dhe joproduktive).	Në pronësi
384	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e ndriçimit publik.	Në pronësi
314-316	Prona që përdoren në fushën e ujësjellës-kanalizimeve.	Në pronësi
869	Prona që përdoren në fushën e zhvillimit ekonomik (prona shtesë).	Në pronësi

VENDIM
Nr.1643, datë 17.12.2008

PËR MIRATIMIN E LISTËS PARAPRAKE TË PRONAVE TË PALUAJTSHME PUBLIKE, SHTETËRORE, QË TRANSFEROHEN, NË PRONËSI OSE NË PËRDORIM, TË BASHKISË VLORE TË QARKUT TË VLORES

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 2, 3 e 17 të ligjit nr.8744, datë 22.2.2001 "Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e listës paraprake të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen, në pronësi ose në përdorim të bashkisë Vlorë, të qarkut të Vlorës sipas lidhjes nr.1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Lista paraprake, sipas kërkesave të këshillit të kësaj bashkie, është pjesë e listës së inventarit të pronave të paluajtshme publike shtetërore, që janë brenda juridiksionit territorial dhe administrativ të bashkisë Vlorë të qarkut të Vlorës, miratuar me vendimin nr.639, datë 29.9.2007, të Këshillit të Ministrave "Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore në Bashkinë Vlorë, të qarkut të Vlorës".

2. Ngarkohen Ministria e Brendshme dhe bashkia Vlorë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Bashkia Vlorë	Lidhja nr.1	
Numrat renderë të pronave në listën e inventarit	Fusha e përdorimit të pronës	Lloji i transferimit
1-34	Prona që përdoren për realizimin e programeve arsimor.	Në pronësi
46,48,50-56,58-61	Prona që përdoren për	Në pronësi

	realizimin e veprimtarive social-kulturore e sportive.	
44,45	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e shëndetësisë.	Në pronësi
99-103,118,122	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e shërbimit social.	Në pronësi
79,83-87,151-153	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e administratës.	Në pronësi
116	Varrezat publike.	Në pronësi
104-115,117,119-121,123-150,645-823	Infrastrukturë (sheshe, rrugë vendore, lulishte dhe shërbime publike).	Në pronësi
74,154,504,576	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e zhvillimit ekonomik.	Në pronësi
155-471	Prona që përdoren në fushën e strehimit e mbrojtjes civile.	Në pronësi
626-628,630	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (toka produktive).	Në përdorim
629	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (kanale të treta dhe toka joproduktive).	Në pronësi

VENDIM
Nr.107, datë 9.9.2008

PËR DISA NDRYSHIME NË DEKLARATËN RREGULLATORE TË MIRATUAR ME VENDIMIN NR.94, DATË 14.8.2008 "PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.87, DATË 6.8.2008 "PËR MIRATIMIN E DEKLARATËS RREGULLATORE NË KUADËR TË ZBATIMIT TË METODOLOGJIVE TË LLOGARITJES SË TARIFAVE TË ENERGJISË ELEKTRIKE"

Në mbështetje të neneve 9 dhe 26 të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë në mbledhjen e tij të datës 9.9.2008, në kuadër të ushtrimit të autoritetit për zbatimin e metodologjive të vendosjes së tarifave dhe çmimeve të energjisë elektrike, pasi shqyrtoi relacionin e paraqitur nga Drejtorja e Çmimeve dhe Tarifave, për disa ndryshime në deklaratën rregullatore,

VENDOSI:

1. T'i miratojë ndryshimet në deklaratën rregullatore të miratuar me vendimin nr.94, datë 14.8.2008 të Bordit të Komisionerëve të ERE-s "Për miratimin e deklaratës rregullatore në kuadër të zbatimit të metodologjive të llogaritjes së tarifave të energjisë elektrike".
2. Deklarata rregullatore me ndryshimet përkatëse i bashkëlidhet këtij vendimi.
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
Keshilli i Bashkise
Vlore

Wale nga Kuvendi
e Bashkisë Vlore
më datë 02.03.2008
Cpaktitor bashkëcidhu

Spunjtunif

Adresa: Sheshi "4 Heronjtë". Tel: 033 22985; Fax: 033 24275; E-mail: info@bashkia.vlore.org

Nr. _____ prot

Vlorë, me 5 5 2008

VENDIM

Nr. 16

Dt. 5 5 2008

PER:

"MIRATIMIN E LISTES PARAPRAKE TE PRONAVE TE PALUAJTSHME PUBLIKE SHTETERORE QE TRANSFEROHEN NE PRONESI OSE PERDORIM TE BASHKISE VLORE"

Keshilli i Bashkise ne mbledhjen e dates _____ bazuar ne ligjin nr.8744 dt.22/02/2001 " Per transferimin e pronave te paluajtshme publike te shtetit ne njesite e qeverisjes vendore "pikes 4. te V. K. M. nr. 500 date 14.08.2001 " Per Inventarizimin e pronave te paluajtshme shteterore dhe transferimin e pronave ne njesite e qeverisjes vendore " dhe ligjit nr. 8652 date 31.07.2000 " Per organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore " neni 8 paragrafi II , germa "c "

VENDOSI :



1. Miratimin e listes paraprake te pronave te paluajtshme shteterore qe kerkohen te transferohen ne pronesi dhe ne percërim te Bashkise Vlore.

Numrat rendor te pronave ne listen e inventarit	Fusha e perdorimit te prones	Lloji i transferimit
1-34 , ,80,81, 99-103,118,122	Prona qe perdoren per realizimin e programeve arsimore	Ne pronesi
44,45	Shendetesi	Ne pronesi
46,47,50-56,58-61	Prona qe perdoren per realizimin e programeve social -kulturore , sportive	Ne pronesi
83-87, 93,111 -115, 117,119-121, 123-139, 140-150, 576, 635-640, 645-823	Infrastruktura (rruge vendore , lulishte, ndriçim dhe sherbime publike).	Ne pronesi
155-471 ,74,104-110	Prona qe perdoren ne fushen e strehimit dhe mbrojtjes civile	Ne pronesi
585-613 .	Pyje dhe kullota	Ne pronesi
154	Prona qe perdoren ne ushtrimin e funksioneve ne fushen e zhvillimit ekonomik.	Ne pronesi
79,151-153	Prona qe perdoren ne ushtrimin e funksioneve ne fushen administrative.	Ne pronesi ,

1
C
#8.11.12
LORE

625/5 ,625/7	Varreza publike Infrastruktura , troje te lira	Ne pronesi Ne pronesi
626-628	Toka bujqesore produktive dhe ne perdorim.	Ne perdorim
629. 630	Toke bujqesore joproductive	Ne pronesi

Arben SINANAJ
KRYETAR

P



6/10



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA VLORE
DREJTORIA JURIDIKE

Adresa: Sheshi "4 Heronjtë", Tel: 033 22985; Fax 033 24275; www.bashkiavlore.org; E-mail: info@bashkiavlore.org

Nr. _____ prot

Vlore, me _____ 2008

Keshillit te Bashkise
Vlore

Relacion

Ne projekt vendimin « Per miratimin e listes paraprake te pronave te paluajtshme publike shteterore qe transferohen ne pronesi ose ne perdorim te Bashkise Vlore ».

Te nderuar keshilltare :

Me vendimin Nr. 31/1 Dt. 07.07.2006 te Keshillit te Bashkise Vlore eshte miratuar inventari i pronave shteterore qe jane ne territorin e Bashkise Vlore Kjo liste pronash eshte miratuar edhe me vendimin Nr. 639 Dt. 29.09.2007 te Keshillit te Ministrave i cili i eshte derguar Bashkise Vlore se bashku me rekomandimet perkatëse.

Pas miratimit nga Keshilli i Ministrave sipas rekomandimeve te tij ne piken 3 ,kjo liste eshte shpallur publikisht dhe nga administrata e Bashkise jane evidentuar gjithë verejtjet dhe pretendimet e bera nga shtetas te ndryshem . Gjithashtu jane vleresuar pronat ne funksion te qellimit per te cilin perdoren ne zbatim te nenit 3 te ligjit me Nr. 8744 Dt. 22.02.2001 « Per transferimin e pronave te paluajtshme publike te shtetit ne njesite e qeverisjes vendore »

Nga analiza e bere rezulton se vetem nje pjese e ketyre pronave , i sherbejne Bashkise Vlore per kryerjen e funksioneve te saj , nderkohe qe ne listen e miratuar me pare jane perfshire gjithë pronat e paluajtshme bre.nda territorit te saj. Duke qene se ne listen e pronave te inventarizuara jane perfshire edhe prona qe aktualisht jane ne funksion teshendetesise , ushtrise , policise etj nga Keshilli i Bashkise kerkohet qe te miratoje vetem ato prona qe faktikisht perdoren dhe sherbejne per kryerjen e funksioneve te Bashkise si organ i qeverisjes vendore.

Ne projekt vendimin e paraqitur para Keshillit per miratim jane veçuar vetem pronat e Bashkise sipas funksionit per te cilin perdoren . Nisur nga fakti se lista e inventarit eshte 81 faqe dhe numer rendor nga 1-825 do te thote se jane inventarizuar po kaq prona te cilat jane miratuar dhe njihen nga ana juaj, ne projekt vendimin jane listuar vetem numrat rendor te pronave .

Projekt vendimi eshte i perpiluar vetem me numer rendor pasi edhe vendimi i Keshillit te Ministrave per listen paraprake te pronave qe kerkohet te kalojne ne pronesi te Bashkise del ne te njejten forme. Renditja sipas numrit rendor behet pasi AIPP ne Ministrine e Brendshme pergatit materialin per mbledhjen e Keshillit te Ministrave dhe ka te depozituar inventarin e pronave te Bashkise Vlore.

GM/1

Duke vleresuar faktin se ofertat e percaktuara ne dispozitat ligjore jane tejkaluar si dhe per arsye se pas miratimit te listes paraprake me V.K.M. do te vazhdoje procedura per listen perfundimtare kerkojme qe Keshilli i Bashkise te beje mratimin sa me shpejt te jete e mundur . Rendesia e regjistrimit te pronave te Bashkise shtohet sidomos me daljen e ligjit Nr. 9869 Dt. 04.02.2008 « Per huamarrjen e qeverisjes vendore « i cili mundeson edhe per organet e qeverisjes vendore marrjen e kredive per zhvillimin e projekteve te ndryshme .

Duke shpresuar ne vleresimin tuaj per projekt vendimin e paraqitur kerkojme ta miratoni ate .
Ju faleminderit.



Daut ZERAJ
DREJTOR

Handwritten signature or initials in blue ink.



115011
15.05.2008

REPUBLIKA E SHQIPERISE
PREFEKTI I QARKUT VLORE
Sektori Juridik dhe Funksiioneve te Deleguara

Nr...346...Prot.

Vlore , me...15.05.08...

Lenda : Shprehja per ligjshmerine e vendimit te Keshillit te Bashkise Vlore

Drejtuar : Z. Shpetim GJIKA
Kryetar i Bashkise
Vlore

Per dijeni : Keshillit te Bashkise
Vlore

Ne mbeshtetje dhe zbatim te neneve 6 dhe 14 te Ligjit Nr.8927, date 25.07.2002 "Per Prefektin", shprehemi si me poshte :

1.Vendimi i Keshillit te Bashkise Nr.15, date 08.05.2008 " Mbi proceset gjyqesore te Bashkise Vlore", **miratohet si kopetence.**

2. Vendimi i Keshillit te Bashkise Nr. 16 date 08.05.2008 " Mbi miratimin e listes paraprake te pronave te paluajteshme publike shtetore qe transferohen ne pronesi ose ne perdorim te Bashkise Vlore", **miratohet si procedure.**

3. Vendimi i Keshillit te Bashkise Nr. 18 date 08.05.2008, " Mbi vendosjen e gjobave per shkeljet e kryera nga shoqerite e ndertimit", **miratohet si kopetence.**

4. Vendimi i Keshillit te Bashkise Nr. 19 date 08.05.2008 , " Mbi menyren dhe masen e perdorimit te te ardhurave financiare te krijuara nga biletat dhe qerate ne institucionet e Qendres Kulturore Vlore", **vleresohet i ligjshem.**

5. Vendimi i Keshillit te Bashkise Nr. 20 date 08.05.2008, "Per shperblim per titullin, kampion ne basketboll femra dhe kupa e Shqiperise per te rritur ne peshengritje" **vleresohet i ligjshem.**

6. Vendimi i Keshillit te Bashkise Nr. 21 date 08.05.2008, "Mbi miratimin e ngritjes se komisioneve per dhenien e Licensave Profesionale per Sherbimet Publike dhe funksionimin e tyre" **vleresohet i ligjshem.**

Shprehja e ligjshmerise si me siper i njoftohet per zbatim Kryetarit te Bashkise. U konfirmua sot me 13.05.2008.

PREFEKTI

Xhevair REXHEPI





Dalë nga Arkivi
e Bashkisë Vlorë
me date 02.03.2026
(praktika bashke Cidhues)
Spentunaj

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA VLORE
KËSHILLI I BASHKISË

Nr. 1901 prot.
1

Vlorë, më 29 . 03 2022

VENDIM

Nr. 25, Datë. 23.03.2022

